

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË

CHBS Sh.p.k.

Sot, më datë 20.3.2022, në Tiranë, palët e mëposhtme, kanë vendosur me vullnetin e tyre të plotë, të hartojnë këtë Akt Themelimi të Shoqërisë 'CHBS Sh.p.k'.

Michael Weinhara, lindur më 23.7.1962, në Kaufbeuren, Gjermani, me nënshtetësi gjermane, me nr. pasaporte CGN85CKT6, banues në Gjermani, me adresë Beethoven str.1, 87600, Kaufbeuren.

Neni 1

Data e themelimit, emërtimi dhe themeluesit

Shoqëria 'CHBS Sh.p.k' krijohet në datë 20.3.2022, nga ortakët si më poshtë:

Michael Weinhara, lindur më 23.7.1962, në Kaufbeuren, Gjermani, me nënshtetësi gjermane, me nr. pasaporte CGN85CKT6.

Neni 2

Personaliteti juridik

2.1 Shoqëria është person juridik shqiptar.

2.2 Shoqëria e fiton personalitetin juridik shqiptar, që prej datës në të cilën kryhet regjistrimi i saj në Qendren Kombëtare të Biznesit.

2.3 Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në dokumentet themeluese (Akt Themelimi dhe Statut).

Neni 3

Forma e shoqërisë

3.1 Shoqëria do të ketë formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, derisa me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të vendoset shndërrimi i formës ligjore.



Neni 4

Objekti

4.1 Shoqëria 'CHBS Sh.p.k' do të ketë si objekt të veprimtarisë:


- Shërbime konsulence (Menaxhimi i sistemeve të informacionit shëndetësor dhe jo vetëm, planifikimi dhe menaxhimi i burimeve njerëzore në sektorin e kujdesit shëndetësor dhe jo vetëm, Analiza e riskut në sektorin e kujdesit shëndetësor dhe jo vetëm, Integrimi social, Mbrojtja dhe zhvillimi social dhe mjedisor, Rehabilitimi dhe dizenjimi spitalor, Planifikimi i njësive të kujdesit shëndetësor dhe jo vetëm, Mbikqyrja e kontruksioneve spitalore dhe njësive të kujdesit shëndetësor, Përgatitja e tenderave për pajisje dhe punime në njësitë e kujdesit shëndetësor dhe social dhe jo vetëm, Studime fizibiliteti në Sektorin Shëndetësor, Social dhe jo vetëm, Pjesëmarrje në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare të cilat lidhen me zhvillimin e infrastrukturës spitalore, zhvillimin e menaxhimit shëndetësor, mbrojtjen sociale dhe jo vetëm, Përgatitja e trajnuesve të Cilësisë në kujdesin shëndetësor, Mbështetja për menaxhimin e cilësisë në njësitë e kujdesit shëndetësor, Rishikim dhe rikonceptim i veprimeve në sektor, Zbatimi i Sistemit të Raportimit të Menaxhimit të Cilësisë dhe pajtueshmërisë së Korporatave, Përzgjedhja e sistemeve IT dhe implementimi), kryesisht në fushën e menaxhimit shëndetësor por jo vetëm, në favor të subjekteve kombëtare dhe ndërkombëtare, bazuar në porositë e tyre dhe kontratat e nënshkruara.
- Shërbime të ndërmjetësimit të punësimit të profesionistëve të kujdesit shëndetësor dhe jo vetëm, brenda dhe jashtë Shqipërisë
- Ofrimin e Aktiviteteve të Edukimit në Vazhdim për profesionistët e shëndetësisë.

Neni 5

Kohëzgjatja

5.1 Shoqëria 'CHBS Sh.p.k' kryen veprimtarinë e saj tregtare për një periudhë kohore të pacaktuar derisa të vendoset ndryshe nga Asambleja e Përgjithshme.

5.2 Shoqëria fiton personalitetin juridik në datën e regjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit dhe nga kjo datë ajo mund të fillojë të ushtrojë aktivitetin tregtar deri kur me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, të vendoset prishja e shoqërisë ose kur shoqëria mbaron në një nga mënyrat e parashikuara në ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".



Neni 6

Selia

6.1 Selia kryesore e shoqërisë do të jetë në Tiranë, në rrugën 'e Kavajës', pasuria me nr. N-2/168, ZK 8380, kati 3, Njësia Administrative nr. 10. Me vendim të Administratorit, selia e shoqërisë mund të ndryshohet, mund të hapen degë, dhe zyra përfaqësimi të saj brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Neni 7

Vula e Shoqërisë

7.1 Shoqëria do të ketë vulën e saj duke shënuar në të emërtimin tregtar dhe\ose initiale.

Neni 8

Kapitali Themeltar

8.1 Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 30.000 (Tridhjetë mijë) lekë, i zotëruar nga ortakët si më poshtë:

Michael Weinhara 30.000 (Tridhjetë mijë lekë)

8.2 Ky kapital është i ndarë në 1 (një) kuotë të zotëruar nga ortaku si vijon:

Michael Weinhara 1 kuotë me vlerë 100% të kapitalit fillestar.

8.3 Kapitali themeltar do të depozitohet në një bankë në Shqipëri me një llogari të hapur në emër të shoqërisë në formim e sipër ose në arkën e shoqërisë.

Neni 9


Kuotat, të drejtat e lidhura me to

9.1 Cdo kuotë jep të drejtën e një vote për të marrë vendime sipas ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare". Të gjitha votat do të ushtrohen nga ortakët sipas zotërimeve.

9.2 Kuotat e kapitalit të shoqërisë mund të fitohen nëpërmjet kontributit në kapitalin e shoqërisë, shitblerjes, trashëgimise, dhurimit, apo cdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Neni 10

Administrimi i shoqërisë



10.1 Shoqëria administrohet nga një administrator i zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme. Administrator i shoqërisë do të jetë z. Michael Weinhara, lindur më 23.7.1962, në Kaufbeuren, Gjermani, me nënshtetësi gjermane, me nr. pasaporte CGN85CKT6. Afati i ushtrimit të detyrës është 5 (pesë) vjet me të drejtë ripërtëritje.

Neni 11

Dispozita përfundimtare

11.1 Për çështje që nuk parashikohen dhe rregullohen shprehimisht nga ky akt, gjejnë referim dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

11.2 Shoqëria 'CHBS Sh.p.k', regjistrohet sipas sipas neneve 26, 28, 32 e 35 të Ligjit Nr.9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit.", të ndryshuar

11.3 Akti u hartua në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë juridike.

MICHAEL WEINHARA

Michael Weinhara

